



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0030237/25 dt. 23.05.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **premtën** më dt. **30.05.2025**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa
Seanca e 41

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Qarkorja Buxhetore 2026/01

Mbledhja mbahet në Sallën e Mediave duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

sa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0021658-1/25 dt. 25.04.2025

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 40

Koha: 25.04.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel
Neziri, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani Muhamed Hoti dhe Xhylljeta Imeri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Drejtorët e Drejtorive

Mungoi: Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 40-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Në vazhdim Kryesuesja theksoi se me e-mail ka ardhur edhe Procesverbali nga mbledhja e 39-të e KPF-së (mbledhja e jashtëzakonshme), i cili propozohet të hyjë në rend dite bashkë me Procesverbalin nga mbledhja e 38 e KPF-së, votimi bëhet ndaras. Po ashtu kanë ardhur edhe pikat: Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova, Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprake, në vitin 2025 dhe Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025, të cilat propozohen të hyjnë në rend dite si pikë e 3, 4 dhe 5, ndërsa pika e 3 e paraparë me rend dite të kalojë si pikë e 6.

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja propozoi që në rend dite si pike e 1 të hyjë edhe: Procesverbali nga mbledhja e 39-të e KPF-së (mbledhja e jashtëzakonshme).

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi unanimisht (8 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 1 të hyjë edhe: Procesverbali nga mbledhja e 39-të e KPF-së (mbledhja e jashtëzakonshme).

Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim propozimin që pikë e 3 e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova.

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi unanimisht (8 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 3 të hyjë: Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova.

Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim propozimin që pikë e 4 e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprahe, në vitin 2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi unanimisht (8 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 4 të hyjë: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprahe, në vitin 2025.

Kryesuesja e mbledhjes vuri në votim propozimin që pikë e 5 e rendit të ditës të jetë: Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa e miratoi unanimisht (8 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) propozimin që pikë e 5 të hyjë: Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Në vazhdim Kryesuesja vuri në votim këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 38-të e KPF-së dhe procesverbalit nga mbledhja e 39-të e KPF-së (mbledhja e jashtëzakonshme)
2. Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare
3. Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova
4. Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprahe, në vitin 2025
5. Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025
6. Raport financiar për periudhën janar-mars 2025

Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e 38-të e KPF-së u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Procesverbali nga mbledhja e 39-të e KPF-së (mbledhja e jashtëzakonshme) u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).

Pika 2

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Hysen Muzliukaj: Nuk jam kundër kësaj kërkesë por nuk kemi arsyetim se për çka nevojiten këto mjete, kërkesës për mbledhjen e Kuvendit t'i bashkëngjitet plani i detajuar se ku do të shpenzohen këto mjete.

Xhyljeta Imeri: Pajtohem që kërkesa nuk është e detajuar, mirëpo unë e përkrahi dhe jam që të shkojë në Kuvend kjo pikë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare, me propozimin që për mbledhjen e Kuvendit t'i bashkëngjitet plani i detajuar se ku do të shpenzohen këto mjete.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare, me konkluzionin që për mbledhjen e Kuvendit Kërkesës t'i bashkëngjitet edhe plani i detajuar se ku do

të shpenzohen këto mjete. Kërkesa e plotësuar t'i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova nga Kryetari i Komunës, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Vesel Neziri: Diakonie Kosova ka dhënë ndihmesë për nxënësit e shkollës profesionale, duke ndihmuar edhe me mjete financiare, por ajo që kërkoj unë është që nxënësit e shkollës profesionale kur shkojnë në praktikë në Diakonie t'i qasen punës sikurse edhe të tjerët e jo vetëm të shikojnë të tjerët, ku sipas Diakonies kjo qasje nuk iu lejohej për shkak të mungesës së materialit shpenzues.

Hysen Muzliukaj: Në parim jam për, por për mua është diskutabile çështja se përse Kërkesën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova e ka bërë MBPZHR e nuk e ka bërë MPJ, kur dihet se MBPZHR nuk i ka në domenin e saj OJQ-të.

Kryetari Bedri Hamza: Ka praktika kur kërkesa të tilla ka bërë edhe Kryeministria, edhe Ministria e Arsimit dhe ministri të tjera, me këtë rast kemi të bëjmë me parcelë bujqësore dhe mendoj që ministria më adekuate dhe më e profilizuar për këtë çështje është MBPZHR, prandaj unë mendoj që legalisht jemi në rregull.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimit (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për Diakonie Kosova dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprake, në vitin 2025.

Hysen Muzliukaj: Desha me pyet ku mendoni me i qitë mjetet financiare te çerdhja në Shipol, ishte parapa shtatëmbëdhjetë mijë euro diku. E kam një informatë se hala operatori që e ka kry punën nuk i ka marrë paret, ne i kemi qitë do pare edhe vitin e kaluar, nëse e kam informatën, ai operator e ka dërgu në përmbarrim ose në gjykatë lëndën.

Kryetari Bedri Hamza: Çerdhja nuk është përfunduar prej një operatori. Operatori i parë, i cili e ka fitu kontratën, nuk e ka përmbushë kontratën dhe ka lënë pa përfunduar. Dhe nuk është ky i vetmi projekt që e ka lënë pa përfunduar. E ka lënë pa përfunduar edhe ambulancën në Koshtovë. E ka lënë të papërfunduar edhe shkollën në Gushavc, e ka lënë të papërfunduar edhe çerdhen në Shipol, e fatkeqësisht i njëjti operator e ka lënë edhe po e lënë të pa përfunduar, është kontratë me nivelin qendror, por ne si Mitrovicë po flasim edhe çerdhen te shkolla e mesme teknike, edhe unë mendoj që ligjet tona janë goxha problematike dhe mendoj që duhet me u plotësu dhe me u ndryshu edhe një operator ekonomik, jo dy punë, por një që e len ai realisht më nuk duhet me qenë pjesë e garës. Dhe i njëjti operator ekonomik qe dy-tri vjet na sill shkollën e muzikës herë në nivel qendror, herë në OSHP, herë ta kthen, herë andej, herë këndej. Edhe ty të barten mjetet nëpër buxhete, a ti s'mund të nisë punën se lëndën e ke në OSHP. Ky është sa i përket pjesës së operatorit të parë, t'ka sfidu në rrugë ligjore. E keqja është nëse komuna e paditë dikë me realizu një të drejtë të veten nuk di kur vjen në radhë. Prej fillimit të mandatit ka plot lëndë që janë dërguar në procedurë ligjore. Nuk na ka

ardhë radha as me qenë pjesë, as që na kanë ftu në seanca, kur ne i kena lyp paret tona. Kur neve na padit dikush, me procedurë të përshpejtuar vijmë në radhë. E keqja është, edhe unë kam me kërku edhe kam insistu që edhe ata të gjykatës që gjykojnë lëndë edhe veç vendosin gjithmonë në dëm të institucioneve edhe ata me qenë pjesë e procedurave. Nuk mundesh diku që e ka ndërpre kontratën me ia njoftë të drejtën për me t'i marrë paratë, kjo është duke ndodhur, është ritenderu pjesa e mbetur kur është bërë prerja e punëve, e për me përfundu çerdhen, e ka fitu operator tjetër ekonomik. E ka fitu në procedurë, pas shumë rruge, është përfundu çerdhja, dhe kjo pjesë është fatura e fundit, pagesa e faturës së fundit, e situacionit të fundit dhe me këto tetëmbëdhjetë mijë € përmbillet obligimi kontraktual dhe situacioni i fundit edhe fatura e fundit për çerdhen e fëmijëve në Shipol, realisht tash jemi në proces të plotësimit të stafit dhe unë besoj që gjatë muajve të verës, ajo duhet me qenë në funksion të qytetarëve. Po kjo është realiteti, fatkeqësia është që do operator ekonomik duhet me i ndjekë procedurat dhe definitivisht duhet me qenë pjesë e listës zezë dhe në listën e zezë edhe në proces gjyqësor, sepse kur e sheh që për një obligim shtatëdhjetë euro, njëqind euro, me shpenzimet e përmbarimit e të gjitha tjerat, komunën ta ndëshkon me shtatëqind euro, i vjen barra përfundimtare, por kjo është jashtë logjike. Është vendimi i formës së prerë: ty s'të vetë kurrkush, ty veç ta çon përmbarimin edhe ta ekzekuton. Po kjo është z. Muzliukaj, sa i përket çerdhes në Shipol, po flasim për tetëmbëdhjetë mijë euro për operatorin e dytë, jo për të parin, i pari është në procedurë ligjore, qysh përfundojnë procedurat ligjore nuk mundem me i paragjyku. Ai mundet edhe me e fitu lëndën, po edhe na nuk kemi me u ndalë deri në Gjykatë Kushtetuese, unë insistoj që kena me ndjekë.

Hysen Muzliukaj: Pyetja e dytë: Prapë po vendoset 194.145 euro tek rregullimi, riparimi i rrugës “Mbretëresha Teutë”, a u pranua, a u pagu kjo rrugë?

Kryetari Bedri Hamza: Rruga “Mbretëresha Teutë” nuk është pagu. Siç e dini ka pas vështirësi, menaxheri i kontratave për shkak të procedurave ligjore është suspendu, është largu prej punës. Kur janë hapë aktakuzat, ne kemi qenë të detyruar të veprojmë në përputhje me ligjin, dhe projekti nuk është pranua teknikisht, nuk iu kanë pranua as niveli i faturave për punët e kryera, për shkak se duhet të bëhet një komision i jashtëm profesional i cili duhet me i pranua ato punë. Nëse janë kry mirë, i pranoni; nëse janë kry krejt, i pranoni krejt; nëse s'janë kry krejt, i pranoni ato që janë kry. Mirëpo paratë nuk janë pagu, projekti është kry, arsyeja është kjo dhe tash nëse një pjesë e atij obligimit mbulohet me të hyrat e bartura nga vitet paraprake, ndërsa nëse ka tepriçë presim që bashkë me Drejtorinë e Financave, po presim që me ardhë edhe me një propozim për ridestinin të mjeteve gjithmonë brenda ligjit deri në pesëmbëdhjetë për qind, tash sa do të jetë ajo, mbetet me pa sot.

Hysen Muzliukaj: Te Administrata e Shëndetësisë, po shkruan rregullimi i oborrit të QKMF-së “Doktor Nexhat Çuni”. Unë këtë oborr e kam pa që është shtrur, është promovu, profesionalisht dhe ekonomikisht a ishte dashtë me hy në obligime këtu kryetar, pa i pasë mjetet?

Kryetari Bedri Hamza: Nuk jena hi pa mjete, edhe ka qenë fat i mirë që ndoshta një projekt, po flas veç për infrastrukturën në oborr, se shiko kur është ndërtuar QKMF-ja, mendoj që keni pasur mundësinë me shku me vizitu, mendoj që është një objekt që është vlerë e shtume për Mitrovicën. Po ai objekt pa infrastrukturë s'ka pas kuptim. E para është deshtë me marr trafo komplet të re. Ka qenë procedurë shumë e gjatë, e rëndë dhe e mundimshme, sepse trafotja e vjetër është konstatu që nuk ka kapacitete për me furnizua atë objekt dhe pajisjet e atij objekti me energji elektrike që me mujt me funksionu pa problem. E dyta, oborrrin kam negociu goxha me zor, kam arritë marrëveshje me Jetimat e Ballkanit, me Halil Kastratin, që me bashkëfinancu edhe rregullimin e oborrit. Edhe këtu në rregullim të oborrit, sa e di unë jemi në bashkëfinancim gjashtëdhjetë-katërdhjetë, domethënë gjashtëdhjetë për qind. Është donacion katërdhjetë për qind të vlerës totale të infrastrukturës, që përfshin trafon, që vlera e trafos ka qenë diku shtatëdhjetë mijë euro. Edhe e keqja është që ti e paguan edhe prapë kemi ja kalu në pronësi KEDS-it, këtu përfshihet edhe asfalti, kanalizimi, se është konstatu që kanalizimi nuk ka kapacitete të mjaftueshme për me qenë funksional dhe është bërë kanalizim i ri edhe neve për me e përmbyllë total kontratën, memorandumun e parë edhe memorandumun e dytë, që i dyti është shtesë i të parit, diku vlera totale sa s'gaboj rreth pesëqind mijë euro, do të thotë këto janë obligimi ynë i fundit për me pagu në raport me Jetimat e Ballkanit. Domethënë, ne

kemi obligim edhe gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë euro. Kjo është arsyeja pse janë këtu gjashtëdhjetë mijë euro për këtë projekt.

Hysen Muzliukaj: Te “Mbretëresha Teutë”, mos po kalohen krejt afatet e mundshme për pagesë, edhe a ka tendenca të operatorit me na dërgu në përbarim?

Kryetari Bedri Hamza: Operatori mundet me shfrytëzu të drejtën e vet ligjore dhe s'mund t'ia ndalim. Tek e fundit, operatorit nuk i intereson çfarë vështirësish ti ke pas brenda. Sa unë jam në informacion, nuk besoj që ka tendencë me na dërgu në përbarim, por nëse ne s'ia paguajmë në një moment, ai ka me 'ti marrë, por edhe përmes përbarimit unë uroj që mos të vijë puna deri aty, se na rritet kostoja.

Zenel Çitaku: Ne jemi tu folë për një proces të bartjes së të hyrave. Buxheti për vitin dy mijë e njëzet e pesë siç e dini është plan, dhe nuk nënkupton determinisht edhe shpenzimin e tij. Ky proces i bartjes së tyre vjen qysh e tha edhe Kryetari, janë mjete që kanë mbet prej vitit 2024 dhe viteve tjera edhe do të barten në planin e buxhetit për vitin 2025. Unë krejt çka muna me ju siguru, janë që pavarësisht këtyre vlerave që janë këtu, të gjitha pagesat që i plotësojnë kushtet ligjore për me u procedu, kanë me procedu.

Fadil Veseli: Po meqenëse shuma veç është e definuar me tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë euro, krejt çka po më intereson, a ka tjera? Edhe e dyta, kështu kur t'i shikojsh vizualisht bie në sy te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shuma pak e madhe. Kisha me u ndalë te rruga e Shipolit që po na paraqet telashe, me i vu do shenja sinjalizuese që vërehen. Tjetër çka kisha dashtë, nëse ka mjete shtesë, mundësisht t'i ipet rëndësi liqenit, mirëmbajtjes së liqenit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprake, në vitin 2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2024 dhe vitet paraprake, në vitin 2025 dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025 për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Bedri Hamza.

Pas arsyetimit të Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025 nga ana e Kryetarit të Komunës, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Hysen Muzliukaj: Kryetar të njëjtën vërejtje po ta dha qysh ia kemi dhënë vetit, kur themë vetit, për Planin e Kuvendit, mendoj që është tepër vonë. Besoj që stafi yt ish dashtë me përgatitë këtë. Vetë e the që është në lidhje direkte me buxhetin, buxheti është votu në shtator, plani nis gjithë me u punu në muajt nëntor-dhjetor për vitin e ardhshëm. Realisht nëse e këqyrim, duhet me u votu në dhjetor për me qenë i gatshëm në janar. Njëjtë e kam kritikë edhe Kuvendin për këtë pjesë.

Kryetari Bedri Hamza: Jo që po e pranoj, por po e pranoj fort, edhe po pajtohna, se megjithatë jemi në prill dhe realisht kanë shku katër muajt e vitit, ka mujt me ardhë më herët, ka mujt me ardhë në seancën në dhjetor e ka mujt me ardhë në seancën e janarit apo të shkurtit.

Xhyljeta Imeri: Unë do të ndalem vetëm shkurtimisht tek Drejtoria e Arsimit. Fatkeqësisht që nuk e kanë planifiku, nuk e kanë parë të arsyeshme që të bëhet klasa aneks në Shkollën e Suhodollit, ku është një klasë e improvizume e cila nuk i plotëson kushtet. Për mua është shumë shqetësuese se janë ndarë në vitin e kaluar dyzet mijë euro për këtë hapësirë, i ka marrë përbaruesi, po pse nuk është planifiku prapë për 2025-në, shumë keq! Gjithashtu uroj që gjashtë psikologë që i keni planifiku dhe pesëmbëdhjetë asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta të punësohen, të realizohen këto punësime, por edhe do të jeni të parët si qeverisje që do t'i plotësoni stafin arsimor me psikologë nëpër shkolla, janë shumë të rëndësishëm e shumë të nevojshëm. Nuk e di a do të keni hapësirë në ridestinimin e mjeteve që të hyjë prapë kjo klasë për

rregullimin e saj ose ndërtimin e saj, se është shumë e rëndësishme. Por ju kisha ftu se nëse e shihni fizikisht me të vërtetë do të gjeni çdo mënyrë për të bërë një klasë edhe një anë tjetër është fatmirësi që ajo shkollë ka qenë drejt shuarjes sepse prindërit kanë qenë të prirur më shumë t'i dërgojnë fëmijët në qytet, aty është gjallëru shkolla, numri është tu u rrit vazhdimisht, është investim me të vërtetë i rëndësishëm.

Kryetari Bedri Hamza: Unë mendoj që në atë shkollë ka me u rrit numri edhe në të ardhmen sepse besoj që në atë pjesë të qytetit ka me u rritë edhe dendësia e popullsisë dhe uroj që të bëhet ashtu. Unë kam me i bërë të gjitha veprimet e mundshme që një gjë e tillë me u realizu. Sa i përket plotësimit të stafit me psikologë, unë shumë e përkrahi dhe nuk është proces shumë i rëndë me e menaxhu. Vitin e kaluar nuk kemi mujt. Këtë vit është kriju një situatë pak ma ndryshe: përmbaruesi privat nuk të lejon me i ekzekutu mjetet prej masës së pagave, mirëpo rritja e pagave për një koeficient, për gjysë koeficienti që ka ndodhë në janar a gjysë koeficienti që pritët me ndodhë më vonë, nuk ka ndodhë buxhetimi i mjeteve nëpër organizata buxhetore, domethënë ti paguan po niveli qendror e ka bërë një kontingjencë për këtë qëllim, por këtë kontingjencë nuk e ka shpërndarë nëpër organizata buxhetore edhe nuk e di a e shpërndan. Na i kemi si Komunë, si Organizatë Buxhetore ndoshta rreth njëqind e shtatë pozita të paplotësuar në total. Realisht, na jo që s'duhet me pas mungesë të mjeteve financiare, por u deshtë me pas tepriçë. Po realisht psikologët dhe asistentët është më lehtë me i menaxhu si proces.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-mars 2025.

Hysen Muzliukaj: Kërkoj që këtij raporti për Kuvendi t'i bashkangjitet edhe Lista - Shpalosja e pagesave direkte (vendimet përmbarimore dhe gjyqësore) nga Thesari i Kosovës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2025, me kërkesën e z. Muzliukaj.

Komiteti për Politikë dhe Financa miraton unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) Raportin financiar për periudhën janar-mars 2025 dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:15 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesja e Kuvendit

Merita PRETENI

Vesa BROJA

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere / Ministry of Finance, Labour and Transfers

DATE/A:	15.05.2025
PËR/ZA/TO:	Ministrat, Kryetarët e Komunave, Kryeshefat e Agjensioneve, Udhëheqësit e Organizatave buxhetore, Drejtorët e Drejtorive Komunale, Zyrtarët Kryesor Financiar,
NGA/OD/FROM:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punë dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2026/01

Hekuran Murati
Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Per: 



Qarkorja Buxhetore 2026/01

1. Qëllimi

Në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ministri për Financa, Punë dhe Transfere është i autorizuar dhe përgjegjës të lëshojë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore, me qëllim të ofrimit të udhëzimeve për përgatitjen e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministri lëshon Qarkoren Buxhetore 2026/01, e cila përmban udhëzimet e para për hartimin e buxhetit për vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. Kjo qarkore përfshin gjithashtu kalendarin kohor indikativ për procesin buxhetor dhe kufijtë fillestarë buxhetorë për vitin 2026, përkatësisht vlerësimet për vitet 2027-2028 për secilën organizatë buxhetore.

Në rast nevojë, pas kësaj qarkoreje do të lëshohen edhe qarkore të tjera plotësuese deri në finalizimin e plotë të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe vlerësimeve për vitet pasuese.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 mbështet në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë 2026-2028 dhe kornizën makro-fiskale për të njëjtën periudhë. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrahë kërkesat e organizatave buxhetore, në përputhje me orientimet sektorial buxhetor dhe prioritetet e përcaktuara në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar përmes Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, dhe strategjive sektoriale, si dhe nëpërmjet dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, si Programi për Reforma në Ekonomi 2025-2027 dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Prioritetet e Qeverisë për periudhën trevjeçare të ardhshme përqendrohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjen e punësimit, dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, që mbrojnë mjedisin dhe sigurojnë ruajtjen e tij për brezat e ardhshëm. Po ashtu, një tjetër prioritet është orientimi drejt transformimit digjital.

Projeksionet fiskale kanë përcaktuar burimet e mundshme të financimit që Qeveria mund të disponojë për shpenzime në vitin 2026, si dhe vlerësimet për vitet 2027-2028. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve të përcaktuara në këtë qarkore do të bëjë të detyrueshëm ndryshimin e burimeve të financimit, përfshirë mundësinë e rritjes së burimeve të financimit dhe/ose ndryshimin e politikave tatimore për të siguruar të hyra shtesë.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit, duhet të merren parasysh zotimet tona ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Qarkorja Buxhetore 2026/01 është hartuar në përputhje me obligimet e deritanishme nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe ato në proces negociate, duke pasqyruar përkushtimet për politikën fiskale në përputhje me kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar.



3. Parashikimet për implementimin e buxhetit 2026

Para paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2026, organizatat buxhetore duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve një parashikim të realizimit të buxhetit për vitin 2025, deri në fund të tij, në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve individuale. Gjithashtu, organizatat buxhetore janë të obliguara të identifikojnë dhe të informojnë Ministrinë për nënshpenzimet eventuale në buxhetin aktual, si dhe për pritshmëritë për mbi-shpenzimet para se të paraqesin kërkesat buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028.

4. Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për 2026-2028

Procesi buxhetor për vitet 2026-2028 ka për qëllim të lidhi planet dhe politikat buxhetore me prioritetet e Qeverisë. Në nivel sektorial, kjo është realizuar duke prioritetizuar sektorët buxhetorë sipas projeksioneve për periudhën 2026-2028. Përmes kësaj qarkoreje, kërkohet që organizatat buxhetore të konkretizojnë kërkesat e paraqitura, duke detajuar përgatitjen e buxhetit në nivelin e programeve, nën-programeve, kategorive të shpenzimeve dhe projekteve specifike.

Kërkesat për shpenzime të reja duhet të paraqiten vetëm nëse ka hapësirë fiskale të lirë dhe nëse ato janë përfshirë në projeksionet për periudhën 2026-2028. Gjatë procesit buxhetor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të sigurohet që totali i shpenzimeve për të gjitha organizatat brenda një sektori të mos e kalojë shumën e parashikuar në projeksionet për sektorin për vitet 2026-2028.

Organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së kërkesave të tyre, t'u japin prioritet:

- Projekteve që kontribuojnë në realizimin e prioritetëve të Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.
- Projekteve që janë në vazhdimësi nga vitet e kaluar dhe kanë obligime kontraktuale, përfshirë edhe ato të shpronësimit të lidhura me këto projekte.
- Zotimeve të Qeverisë për Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për programin Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA).
- Legjislacionit të ri ose ndryshimit dhe plotësimit të legjislacionit ekzistues.
- Obligimeve për financim të jashtëm për projekte individuale, të cilat duhet të përfshihen brenda ndarjeve buxhetore.
- Aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me Agjendën e reformave në kuadër të Planit të rritjes.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi në formë të tabelës mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2026 dhe projeksionet për vitet 2027-2028 dhe

- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet nga OB-të në nivel qendror dhe lokal zbatimit të çështjeve si në vijim:
 - OB-të të mos propozojnë aktivitete apo projekte të reja pa i dhënë prioritet buxhetimit të obligimeve për aktivitetet/projektet kapitale. Në përputhje me rekomandimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, OB-të të dërgojnë në MFPT informatë lidhur me paditë e ngritura së bashku me një vlerësim nga zyrat ligjore për mundësinë e materializimit/shndërrimit të tyre në obligime;
 - OB-të janë të obliguara të plotësojnë të dhënat që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP si dhe duhet të parandalojnë keq klasifikimin e shpenzimeve buxhetore. Nëse me rastin e dorëzimit të propozim buxhetit nga OB qendrore apo lokale analisti buxhetor do të identifikojë keq klasifikimet, Departamenti i Buxhetit të njëjtat do t'i largojë nga buxheti, duke përfshirë jo vetëm keq klasifikimet për projektet e reja por edhe ato që janë në vazhdimësi nga viti i kaluar;
 - Projektet e propozuara kapitale të jenë projekte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Projektet të cilat nuk zbatojnë standardet dhe kriteret e parapara ligjore nuk do të lejohen të bëhen pjesë e buxhetit.
 - Me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale, OB-të të dorëzojnë në MFPT arsyeshmërinë për secilin projekt sipas rregullave të sistemit PIP dhe udhëzimeve administrative përkatëse.;
 - Nga OB-të kërkohet që të bëhet regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në sistemin PIP; Ministrinë duhet të ndajnë mjete buxhetore brenda hapësirës fiskale vetëm për realizimin e atyre projekteve kapitale për të cilat në bazë marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat kanë krijuar obligime në të kaluarën;
 - Buxheti i projekteve kapitale të bëhet në përputhje me rregullat në fuqi, ku pjesë e kostos së projektit të jenë edhe *shpenzimet e shpronësimit*. Organizatat buxhetore qendrore dhe lokale, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.
 - Për projektet e reja kapitale të natyrës teknologjisë informative Organizatat Buxhetore para se të aplikojnë për mjete buxhetore duhet të marrin miratim paraprak nga Agjencia e Shërbimit të Informacionit- ASHI (MPB) se një projekt të tillë nuk mund të zbatohet nga ASHI-ja.

Qeveria mund të ndryshojë strukturën e shpenzimeve me qëllim arritjen e prioritetëve të saj, si brenda programeve të një organizate buxhetore, ashtu edhe duke zhvendosur buxhetin nga një organizatë në tjetrën të nivelit qendror, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesat buxhetore duhet të mbështesin politikat prioritare të Qeverisë dhe të fokusohen në fushat e politikave sektoriale, në përputhje me Deklaratën e Prioritetëve Afatmesme të Qeverisë 2026-2028.

Shpenzimet rrjedhëse: Organizatat buxhetore duhet të paraqesin kërkesat e tyre brenda kufizimeve buxhetore të caktuara. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore të respektojnë kufijtë e përcaktuar në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Pozitat e reja do të lejohen vetëm brenda numrit të aprovuar të pozitave dhe buxhetit për pozitë e paplotësuara sipas udhëzimeve të dhëna me qarkore.

Pagat dhe shtesat: Për kalkulimin e pagave për vitin 2026 për pozitë aktuale është marrë për bazë për përllogaritje muaji mars 2025 duke përfshirë rritjen e planifikuar të koeficientit për 0.5 sipas Ligjit

mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025. Ndërsa për punëtorët e papunësuar është përlogaritur paga mesatare dhe është buxhetuar vetëm deri 40%, brenda kufizimeve buxhetore.

Mallra dhe shërbime: Organizatave buxhetore do t'i mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2025.

Subvencionet dhe transferet: Në kuadër të kësaj kategorie do të vazhdohet me ndarjen e mjeteve për zbatimin e skemave sociale dhe pensionale përfshirë këtu edhe rritjen natyrale të skemave pensionale, subvencionimet në bujqësi si dhe politikat e reja tani më të aprovuara në Qeveri.

Investimet kapitale: përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe, në periudhën afatmesme, pritet të përfaqësojnë rreth 26% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet të realizohen projekte kapitale të bazuara në një listë prioritetesh, që përfshijnë iniciativa me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike, si dhe përmirësimin e kushteve në sektorët e arsimit, shëndetësisë, sistemit social, mbrojtjes dhe sigurisë, etj. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës afatmesme pritet të financohet nga buxheti i rregullt, ndërkohë që një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohen të financohen përmes huazimit të jashtëm, duke përdorur klauzolën e investimeve.

Përparësi në financim do të kenë projektet që janë në fazën e realizimit, si dhe ato që janë plotësisht në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Kufijtë buxhetorë për investimet kapitale nëpër organizatat buxhetore janë indikativë, dhe Qeveria mban të drejtën t'i rregullojë ata në përputhje me arsyeshmërinë e projekteve që propozohen nga organizatat buxhetore.

Për organizatat buxhetore që konkurrojnë për fonde huamarrjeje (nga deficitin buxhetor prej 2%, përmes fondit 04) dhe nga klauzola e investimeve – përmes fondit 06 (ku aplikimi për fonde nga klauzola mund të bëhet vetëm për projekte kapitale), është e domosdoshme që projektet të përmbushin kriteret e përmendura më parë. Kjo përfshin gjithashtu analizën e shpenzimeve rrjedhëse para, gjatë dhe pas përfundimit të projektit, të cilat duhet të jenë të përshtatshme dhe të përfshira në projekSIONET financiare të organizatës buxhetore.

5. Programi për investime publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale realizohet nëpërmjet rregullave dhe sistemit të Programit për Investime Publike (PIP). Prioritetet strategjike të Qeverisë, të përcaktuara në “Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2026–2028”, përbëjnë bazën për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe për identifikimin e projekteve kapitale.

6. Indikatorët e performancës

Organizatat buxhetore, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal, janë të obliguara të prezantojnë indikatorët e performancës të përmbledhur sipas objektivave dhe aktiviteteve përkatëse në nivelin e tyre organizativ, në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Çdo organizatë buxhetore duhet të paraqesë nga 1 deri në 5

